

KORRIK 2026

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

TAKIM I MINISTRI TË DREJTËSISË ME DEGËT TERRITORIALE TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË



Ministri i Drejtësisë, zoti Toni Gogu, zhvilloi një takim me punonjësit e degëve territoriale të institucioneve të varësisë në qytetin e Tiranë. Gjatë takimit me juristët e Ndhmës Juridike Falas, zoti Gogu vlerësoi këtë shërbim dhe diskutoi mbi rritjen e cilësisë së shërbimit për qytetarët përfitues.

INTERVISTË MBI NDRYSHIMET LIGJORE NË LIGJIN PËR NDIHMËN JURIDIKE FALAS

Koordinatorja për të Drejtën e Informimit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, znj. Helga Çela, ishte pjesë e emisionit “Në kohë reale” në RTSH, për të diskutuar mbi ndryshimet ligjore në Ligjin Nr. 111/ 2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.



DËGJESA PUBLIKE ME QYTETARËT

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka zhvilluar Dëgjesa Publike me qytetarët e Njësisë Administrative numër 7, numër 2 dhe numër 4 në kryeqytet. Gjatë takimit qytetarët patën mundësinë të parashtrojnë pyetje, ndajnë shqetësimet e tyre si dhe kanë marrë informacionin e nevojshëm mbi shërbimet e ofruara nga sistemi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti.



AKTIVITETE TË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

QSHNJP Kukës, në datën 08.07.2026, mori pjesë në aktivitetin "Dita e Drinit", të organizuar në fshatin Metaliaj, Bashkia Has, me qëllim promovimin e mbrojtjes së mjedisit dhe ndërgjegjësimin për ruajtjen e lumit Drin.



QSHNJP Kukës, në datën 10.07.2026, zhvilloi një takim me përfaqësues të Qendrës për Mirëqenie PsikoSociale Kukës për të diskutuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe referimin e rasteve në nevojë.



QSHNJP Kukës, në datën 15.07.2026, zhvilloi një takim pranë Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë Kukës me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimin e mekanizmave të referimit.



QSHNJP Kukës, në datën 23.07.2026, dha një prononcim për RTSH Kukës për të informuar qytetarët mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe mënyrën e përfitimit të tyre.




QSHNJP Kukës, në datën 30.07.2026, zhvilloi një takim pune me Zyrën Përmbarimore Vendore Kukës dhe Drejtorinë e Shërbimit të Provës Kukës për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe referimin e qytetarëve për ndihmë juridike falas.



QSHNJP Durrës, në datën 13.07.2026, mori pjesë në një aktivitet informues të zhvilluar në Njësinë Administrative Ishëm, në bashkëpunim me Fondacionin "Së Bashku", me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.



QSHNJP Durrës, në datën 16.07.2026, mori pjesë në trajnimin me temë "Mbrotjtja nga diskriminimi", të organizuar nga Fondacioni "Së Bashku".



QSHNJP Durrës, në datën 23.07.2026, mori pjesë në një aktivitet informues të zhvilluar në Njësinë Administrative Manëz, në bashkëpunim me Fondacionin "Së Bashku".



QSHNJP Durrës, në datën 30.07.2026, zhvilloi një aktivitet informues në Njësinë Administrative Katund i Ri.



QSHNJP Durrës, në datën 30.07.2026, zhvilloi një aktivitet informues në formatin "Street Law", në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Personave.



QSHNJP Berat, në datën 30.07.2026, mori pjesë në një trajnim të organizuar nga Bashkia Berat dhe Qendra Psiko-Sociale "Vatra", në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Personave, me qëllim forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në mbrojtjen e viktimave të dhunës.



QSHNJP Korçë, në datën 08.07.2026, mori pjesë në takimin për hartimin e Planit Social 2027 2030, me qëllim identifikimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në procesin e hartimit të planit.



QSHNJP Korçë, në datën 17.07.2026, zhvilloi një aktivitet informues në formatin "Street Law", me qëllim informimin e qytetarëve mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti, kategoritë përfituese, shërbimet e ofruara nga Qendra dhe mënyrën e aksesimit të tyre.



QSHNJP Korçë, në datë 21.07.2026, realizoi intervistë me Rtsh Korça mbi Ndhimën Juridike Falas.



QSHNJP Korçë, në datën 28.07.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatin e Popullit, zhvilloi një takim informues në Bashkinë Maliq mbi të drejtat dhe detyrimet në marrëdhëniet e punës, mbrojtjen nga diskriminimi dhe shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.



QSHNJP Korçë, në datën 29.07.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatin e Popullit, zhvilloi një takim informues me përfaqësues të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë.



QSHNJP Elbasan mori pjesë në Tryezën Teknike me temë "Standartet e Konventës së Stambollit dhe zbatimi i tyre".



QSHNJP Elbasan zhvilloi një takim me Administratorin e Njesisë Administrative Steblevë.



QSHNJP Elbasan, në datën 09.07.2026, mori pjesë në takimin e anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në Bashkinë Elbasan.




QSHNJP Elbasan, në datën 22.07.2026, mori pjesë në aktivitetin "Fuqizimi i koordinimit ndërinstitucional për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e strukturuar të rasteve që kanë nevojë për ndihmë juridike".



QSHNJP Elbasan, në datë 28.07.2026, dha një intervistë për gazetën Albania Express.

QSHNJP Elbasan, në datën 29.07.2026, zhvilloi një aktivitet informues në formatin "Street Law", në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Personave.




QSHNJP Gjirokastrë, në datën 08.07.2026, zhvilloi një intervistë në RTGJ/RTSH me temë ndihmën juridike të garantuar nga shteti, duke prezantuar shërbimet e ofruara, rastet e trajtuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, kategoritë përfituese dhe platformën "Juristi Online".



QSHNJP Gjirokastrë, në datën 22.07.2026, zhvilloi një takim me Kryetaren e Zyrës Përmbartimore Gjirokastrë.

QSHNJP Gjirokastrë, në datën 29.07.2026, mori pjesë në takimin ndërinstitucional mbi zbatimin e Ligjit për Amnistinë dhe të drejtat e personave përfitues, ku u diskutua roli i institucioneve në informimin, orientimin juridik dhe garantimin e aksesit në drejtësi.



QSHNJP Gjirokastrë, në datën 30.07.2026, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues me komunitetin rom në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Personave, me qëllim informimin mbi fenomenin e trafikimit, të drejtat e viktimave dhe mekanizmat e mbrojtjes e raportimit.

QSHNJP Vlorë, në datën 02.07.2026, zhvilloi një takim me Kryetarin e Shoqatës së Bashkuar të Invalidëve të Qarkut Vlorë.

QSHNJP Vlorë, në datën 21.07.2026, zhvilloi një takim pranë Zyrave të Gjendjes Civile, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.





QSHNJP Vlorë, në datën 02.07.2026, mori pjesë në takimin e organizuar nga Zyra e Diasporës dhe Emigracionit pranë Bashkisë Vlorë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe referimin e rasteve për ndihmë juridike.

QSHNJP Vlorë, në datën 23.07.2026, zhvilloi një takim informues në Njësine Administrative Orikum.



QSHNJP Vlorë, në datën 30.07.2026, në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Personave, zhvilloi aktivitet informues në terren.

QSHNJP Kavajë, në datën 27.07.2026, zhvilloi një takim pune me Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore, Dega Kavajë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët në funksion të aksesit në drejtësi.



QSHNJP Kavajë, në datën 30.07.2026, zhvilloi një aktivitet informues në formatin "Street Law" në Njësine Administrative Luz i Vogël.

QSHNJP Përmet në datën 15.07.2026, mori pjesë në takimin e punës të organizuar nga Shërbimi i Provës, me pjesëmarrjen e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, përmirësimin e referimit të rasteve dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në drejtësi.



QSHNJP Dibër, në datën 23.07.2026, zhvilloi një takim në Njësine Administrative Maqellarë, në kuadër të aktiviteteve informuese në bashkitë e vogla, me qëllim informimin mbi përfitimet nga ligji nr. 111/2017 dhe forcimin e bashkëpunimit për referimin e rasteve që kanë nevojë për ndihmë juridike.



QSHNJP Lezhë, në datën 14.07.2026, zhvilloi një takim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Lezhë, me qëllim informimin mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti, shërbimet e ofruara nga Qendra dhe kategoritë përfituese.

QSHNJP Lezhë, zhvilloi një takim me punonjësen e Ndihmës Ekonomike pranë Njesisë Administrative Balldren.

QSHNJP Lezhë, në datën 28.07.2026, zhvilloi aktivitet informues në formatin "Street Law" në Njësine Administrative Balldren, në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Personave.

QSHNJP Mat, në datën 07.07.2026, mori pjesë në takimin e zhvilluar me anëtarët e Grupit Teknik Ndërsektorial.



QSHNJP Mat, në datën 29.07.2026, mori pjesë në mbledhjen e Grupit Teknik Ndërsektorial për trajtimin e rastit të dhunës në familje.

QSHNJP Mat, në datën 03.07.2026, mori pjesë në mbledhjen e Grupit Teknik Ndërsektorial për trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në zbatim të kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve, me Njësine Administrative Komsi dhe Njësine Administrative Burrel.



QSHNJP Pukë, në datën 16.07.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar në kuadër të "Ditës Botërore të Aftësive të të Rinjve", duke informuar qytetarët dhe të rinjtë mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, këshillimin ligjor dhe orientimin për procedurat administrative.

QSHNJP Pukë, në datën 20.07.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Pukë në bashkëpunim me Qendrën Komunitare "Sot për të Ardhmen".

QSHNJP Pukë, në datën 07.07.2026, zhvilloi aktivitet informues në terren me qëllim informimin e komunitetit egjiptian mbi të drejtat e tyre dhe shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas.



QSHNJP Tiranë, në datën 15.07.2026, zhvilloi një takim informues në bashkëpunim me Community Empowerment Initiative (CEI), pranë Njesisë Administrative Nr. 2.



QSHNJP Tiranë, në datën 22.07.2026, zhvilloi një takim informues në bashkëpunim me Community Empowerment Initiative (CEI), pranë Qendrës Komunitare Shkozë, me qëllim informimin e komunitetit mbi shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, kriteret e përfitimit dhe procedurat për aksesimin e tyre.



QSHNJP Tiranë, në datën 23.07.2026, zhvilloi një takim informues në bashkëpunim me Community Empowerment Initiative (CEI), me qëllim informimin e pjesëmarrësve mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti.



QSHNJP Tiranë, në datën 28.07.2026, mori pjesë në takimin ndërinstitucional të zhvilluar pranë Qendrës Komunitare "Të qëndrojmë së bashku" Kombinat, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit.

QSHNJP Shkodër, në datën 15.07.2026, zhvilloi një aktivitet informues në pedonalen "Kolë Idromeno", Shkodër, me qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas sipas Ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" në bashkëpunim me përfaqësues të Zyrës Rajonale Shkodër të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



QSHNJP Shkodër, në datën 16.07.2026, mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga OJF "Hapat e Lehtë" në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, me fokus forcimin e dialogut ndërinstitucional dhe përmirësimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje.



QSHNJP Shkodër, në datën 27.07.2026, zhvilloi një takim me Administratorin e Njesisë Administrative Postribë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe referimin e rasteve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas.



QSHNJP Fier, në datën 02.07.2026, zhvilloi një takim pranë Bashkisë Patos, me qëllim informimin e qytetarëve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas.

QSHNJP Fier, në datën 16.07.2026, mori pjesë në aktivitetin përmbyllës të projektit "Shëndet për barazi dhe siguri - Forcimi i reagimit ndërinstitucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Fier".



QSHNJP Fier, më datë 28.07.2026, mori pjesë në aktivitetin ndërgjegjësues të organizuar nga KMD pranë subjektit "Musaj - Z", Patos, me fokus informimin mbi barazinë gjinore, të drejtat në marrëdhëniet e punës dhe mbrojtjen nga diskriminimi.



QSHNJP Fier, më datë 28.07.2026, mori pjesë në takimin e ETN-së pranë Bashkisë Roskovec për trajtimin e një rasti të viktimës së dhunës në familje.



QSHNJP Kurbin, më datë 17.07.2026, zhvilloi takim ndërinstitucional me Administratorin e Njesisë Administrative Mamurras, me fokus forcimin e referimit të rasteve dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

QSHNJP Lushnje, në datën 29.07.2026, në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Personave, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Njesisë Administrative Nr. 1 dhe qytetarëve të qytetit të Lushnjes.

